



MBAHET MARSHI MË I MADH NË HISTORINË E KOSOVËS, NË MBËSHTETJE TË LIDERËVE TË UÇK-së ■ FAQE 4-5

POPULLI FOLI: DREJTËSI, JO POLITIKË - LIRI PËR ÇLIRIMTARËT



Dhjetëra - mijëra qytetarë kanë marrë pjesë në marshin "Drejtësi, jo politikë" të mbajtur në Prishtinë, në mbështetje të strategëve të lirisë që po gjykohen në Gjykatën Speciale në Hagë. Marshi

është mbajtur në përvjetorin e 18-të të Pavarësisë së Kosovës. Organizatorët kanë përsëritur se thirrjet për drejtësi nuk janë kundër askujt, por për "dinjitetin kolektiv" të popullit të Kosovës

AKTUALE



WALKER PËR LIDERËT E UÇK-së: JANË TË PAFAJSHËM, MBAJTJA LARG FAMILJEVE ËSHTË PADREJTËSI E TMERRSHME F. 6

RUSIA DHE UKRAINA ZHVILLOJNË RUNDIN E TRETË TË BISEDIMEVE PËR PAQE NË GJENEVË F. 2



KRERËT E SHTETIT NDEROJNË SAKRIFICËN PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS F. 2



SPORT



REALI FITON MINIMALISHT NË LISBONË, VENDOS GOLI I VINICIUSIT F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUSIA DHE UKRAINA ZHVILLOJNË RUNDIN E TRETË TË BISEDIMEVE PËR PAQE NË GJENEVË

GJENEVË, 17 SHKURT - Delegacionet e Ukrainës dhe Rosisë janë takuar të martën në Gjenevë në rundin e ri të negociatave për paqe, të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara, një javë para përvjetorit të katërt të nisjes së luftës së Moskës në Ukrainë. Pritjet për ndonjë marrëveshje janë të vogla, pasi Moska nuk është lëkundur prej kërkesave të saj maksimaliste për territorin ukrainas. Sulmet e Rosisë në Ukrainë po vazhdojnë çdo natë, duke dëmtuar edhe më tepër sistemin energjetik të vendit, teksa ukrainasit përballen me motin e acartë. Disa orë para se delegacionet të takoheshin në Zvicër, Moska kreu sulme të kombinuara në Ukrainë, duke goditur 12 rajone

me 400 dronë dhe 30 raketa. Të paktën tre persona janë vrarë. Sulmet e fundit tregojnë “shkallën në të cilën Rusia i nënvlerëson përpjekjet për paqe”, ka thënë ministri i Jashtëm ukrainas, Andrii Sybiha. Rusia ka thënë se mbrojtja e saj ajrore i ka rrëzuar më shumë se 150 dronë, dhe që një rafineri e naftës ka marrë flakë pas një sulmi ukrainas me dronë. Bisedimet e së martës ndërmjetësohen nga Steve Witkoff, i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan, Donald Trump, dhe Jared Kushner, dhëndëri i presidentit. Ukraina përfaqësohet nga sekretari për Siguri Kombëtare, Rustem Umerov dhe Kyrylo Budanov, shefi i stafit të presidentit ukrainas, Volodymyr



Zelensky. Në delegacionin rus përfaqësohet edhe Vladimir Medinsky, ndihmësi i presidentit rus, Vladimir Putin dhe figura të inteligjencës ushtarake. “Nuk mendoj që duhet të presim ndonjë lajm sot”, ka thënë zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, duke shtuar se bisedimet do të vazhdojnë edhe sot (e mërkurë). Duke folur para gazetarëve, Trumpi ka thënë të martën se

Ukraina “duhet të ulet në tavolinë sa më shpejt”. Trumpi ka dhënë sinjale edhe më parë se e ka humbur durimin nga mungesa e përparimit në zgjidhjen e këtij konflikti katërvjeçar. Rusia zotëron aktualisht 20 për qind të Ukrainës, përfshirë pjesë të rajonit lindor të Donbasit. Kremlini kërkon që Ukraina t’ia dorëzojë gjithë pjesën e mbetur të rajonit, por Ukraina e ka

hedhur poshtë këtë kërkesë. Kiev kërkon që të ketë garanci sigurie prej Perëndimit, para se të arrihet pajtueshmëri për një marrëveshje për paqe me Rusinë. Rundi i ri i bisedimeve vjen pas negociatave trepalëshe në Abu Dabi, po ashtu të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara. Marrëveshje përfundimtare nuk pati – ndonëse palët u pajtueshëm për këmbim të të burgosurve.

TRUMPI: SHBA-ja PO FLET ME KUBËN

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë duke biseduar me Kubën, ka njoftuar presidenti amerikan, Donald Trump. “Po flasim me Kubën tani”, u ka thënë ai gazetarëve rrugës për në Uashington. Trumpi ka thënë se sekretari i Shtetit, Marco Rubio është duke zhvilluar bisedimet. “Ata duhet absolutisht të bëjnë një marrëveshje”, ka thënë Trumpi. Trumpi e ka quajtur Kubën “një

vend të dështuar”. “Do të shohim se si do të dalë gjithçka. Por, Kuba dhe ne po flasim. Ndërkohë, ka një embargo, nuk ka naftë, nuk ka para”, ka thënë presidenti amerikan. I pyetur nëse do të merrte në konsideratë një operacion ushtarak si ai në Venezuelë, Trumpi ka thënë se nuk do të donte t’i përgjigjej kësaj pyetjeje. “Pse do t’i përgjigjesha

kësaj? Nëse do të përgjigjesha, nuk do të ishte një operacion shumë i vështirë, siç mund ta kuptoni, por nuk mendoj se do të jetë e nevojshme”, ka thënë Trumpi. ShBA-ja ka rivendosur bllokadën e saj ndaj Kubës, duke deklaruar qëllimin e saj për të rrëzuar qeverinë komuniste të republikës. Uashingtoni ka vendosur embargo për furnizimet me



karburant për Kubën, e cila tashmë po përballet me

mungesa akute. ShBA-ja më parë arriti të ndalonte furnizimet me naftë në Kubë nga Meksika dhe Venezuela, dhe në rastin e fundit, forcat amerikane kapën presidentin Nicolas Maduro. Uashingtoni ka njoftuar gjithashtu qëllimin e tij për të vendosur tarifa proporcionale importi për mallrat nga vendet që duan të furnizojnë karburant për Kubën.

INDUSTRIA GJERMANE SHKURTOI 120 MIJË VENDE PUNE

BERLIN, 17 SHKURT - Kriza ekonomike godet rëndë industrinë gjermane. Si pasojë industria gjermane ka shkurtuar vende pune në shkallë të gjerë vitin e kaluar. Rreth 5.38 milionë njerëz ishin të punësuar në sektor – afërsisht 124 mijë më pak se një vit më parë. Kjo del nga një analizë e firmës konsulente “EY”, të cilën e ka cituar “DPA”-ja. Humbjet e vendeve të punës në industri ishin pothuajse dy herë më të larta se në vitin 2024, sipas studimit, i cili bazohet në të dhëna nga Zyra Federale e Statistikave dhe mbulon kompanitë me të paktën 50 punonjës. Më e goditur vitin e kaluar ishte industria e automobilëve e cila përballet me vështirësi. Ky sektor shkurttoi rreth 50 mijë vende pune, ndërsa industritë kimike dhe farmaceutike



patën një performancë relativisht më të mirë me një humbje prej rreth 2 mijë vendesh pune në Gjermani. “Industria gjermane është në një krizë të thellë”, ka thënë Jan Brorhilker, ekspert menaxhues i “EY”. Të ardhurat e kësaj industrie janë tkurrur me pothuajse pesë përqind që

nga viti 2023. Në këtë kontekst humbjet e vendeve të punës ende janë të moderuara. Por një gjë është e qartë: “Një rritje e vërtetë dhe e rëndësishme ekonomike do të ishte e nevojshme për të parandaluar humbjet e mëtejshme të vendeve të punës.”

Priten shkurtime të tjera gjatë vitit 2026

Trendi ka të ngjarë të vazhdojë edhe në vitin 2026. Ekspertët në firmën konsulente “EY” kanë frikë se industria do të zvogëlojë më tej fuqinë punëtore këtë vit për shkak të porositë të dobëta dhe presionit të fortë konkurrues. Kësaj i shtohet edhe numri në rritje i falimentimeve, veçanërisht midis furnizuesve të automobilëve, ka thënë Brorhilker. Për më tepër, prodhuesit e makinave po zgjerojnë gjithnjë e më shumë prodhimin, kërkimin dhe zhvillimin jashtë vendit – “në kurriz të vendeve të punës në Gjermani”. Ekonomistët vazhdojnë të mbeten skeptikë. Vërtet ata presin që ekonomia gjermane të rritet me rreth një përqind në vitin 2026,

pas viteve të tëra stanjacioni. Megjithatë, do të duhet kohë që kjo të përkthehet në rezultate të prekshme për bizneset. Ekonomistët parashikojnë një rritje me bazë të gjerë vetëm në vitin 2027, kur miliardat në shpenzimet qeveritare për mbrojtjen dhe infrastrukturën do të kenë efektin e tyre të plotë. Kreu i Institutit Gjerman për Kërkime Ekonomike (DIW), Marcel Fratzscher, ka paraqitur një pamje të zymtë për ekonominë gjermane, nëse qeveria gjermane nuk ndërmerr reforma gjithëpërfshirëse. Ai ka argumentuar se thjesht mungon fuqia punëtore për të arritur normat e rritjes në të kaluarën. Fratzscher ka bërë thirrje për rritje të taksave dhe një ulje të ndjeshme të subvencioneve.

KRERËT E SHTETIT NDEROJNË SAKRIFICËN PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS



PRISHTINË, 17 SHKURT - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një seancë solemne për të shënuar 18-vjetorin e pavarësisë. Presidentja Vjosa Osmani, ka thënë se 18 vjet më parë, Kosova u ngrit nga vuajtja në dinjitet e nga rezistenca në shtetësi. Sipas saj, Kosova është shpallur shtet i lirë, i pavarur e sovran, për t'i dhënë fund një udhëtimi të gjatë e të dhimbshëm, si dhe për të hapur një kapitull të ri të historisë kombëtare.

“Kosova u bë shtet për ta mbrojtur të vërtetën dhe për të mos lejuar kurrë që historia të rishkruhet”, ka thënë ajo.

Osmani ka përmendur edhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke theksuar se ajo ishte e drejtë dhe se çdo përpjekje për ta njollësuar, dëmton themelet e paqes afatgjate. “UÇK-ja është ideali më i madh që kanë ndërtuar shqiptarët ndër shekuj. Kjo luftë ishte e drejtë dhe gjithnjë e pastër. Krerët e UÇK-së që sot gjenden në Hagë, së bashku me mijëra luftëtarë dhe me popullin tonë, u ngritën për liri e dinjitet”, ka thënë Osmani.

Pas saj ka folur edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili ka thënë se Republika e Kosovës është një realitet i pakthyeshëm. “Kosova ishte vendi ku liria vritej; sot është vendi ku liria funksionon, ku liria frymëzon”, ka thënë Begaj.

Të pranishmëve në seancë u

është drejtuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili ka thënë se dita e sotme është ditë përkujtimi për “ata që flijuan shumëçka e gjithçka për Republikën e Kosovës”. “Pa sakrificën e tyre nuk do ta kishim shtetin tonë. Ne kujtojmë sot qëndresën paqësore të viteve 1990 dhe kujtojmë sot Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ne përkulemi me nderim para dëshmorëve dhe përpiqemi ta ruajmë dhe ta lartësojmë Republikën tonë edhe në emrin e tyre”, ka thënë Kurti.

Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë se 17 shkurti i 2008-s ishte dita kur guximi i brezave dhe sakrifica e tyre ishte bërë shpresë e përjetshme për çdo qytetarë.

Më tutje, Hamza ka thënë se në Hagë është duke u gjykuar pjesa më e lavdishme e Kosovës. “Shtetësia nuk është vetëm flamur dhe himn, është siguri dhe drejtësi. Është ruajtje e së vërtetës sonë historike. Sot festojmë por njëkohësisht edhe reflektojmë, sepse ndërkohë që ne ndërtojmë të ardhmen, pjesa më e lavdishme e historisë sonë, lufta çlirimtare është në bankën e të akuzuarve në Hagë. Ata kanë kontribut në shtet. Besimi i Kosovës në drejtësinë ndërkombëtare nuk duhet tradhtuar”, ka deklaruar Hamza.

Kurse kryetari i Lidhjes

Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, në fjalimin e tij në seancën solemne kushtuar 18-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka thënë se rrugëtimi paqësor i ndjekur nga presidenti Ibrahim Rugova dhe ajo e luftës çlirimtare të UÇK-së prej komandantit Adem Jashari, nuk e kanë përjashtuar njëra-tjetrën, por e plotësuan atë.

Kosova ka nisur ceremonitë zyrtare për shënimin e 18-vjetorit të pavarësisë me ngritjen solemne të flamurit shtetëror. Flamuri i Republikës së Kosovës është ngritur në oborrin e ndërtesës së Qeverisë në Prishtinë, në praninë e krerëve më të lartë të shtetit, përfshirë presidenten Osmani, kryeministrin Kurti dhe kryetaren e Kuvendit, Albulena Haxhiu.

Gjatë kësaj ceremonie, Osmani e ka cilësuar këtë ditë si një moment reflektimi dhe krenarie dhe nderoi sakrificën e atyre që kontribuan për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. “Sakrifica ka qenë shekullore, kanë qenë breza të tërë që kanë dhënë gjithçka që sot ta gëzojmë shtetin e Kosovës. Shprehim respektin e thellë për presidentin historik, Ibrahim Rugova, sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë ata që dhanë jetën që ne ta gëzojmë shtetin tonë”, ka thënë ajo.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur po ashtu një seancë solemne, gjatë së cilës Kurti përmendi edhe krerët e Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës që po gjykohen nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Ai ka thënë se shpallja e pavarësisë nuk mund të përkujtohet pa u nderuar ata që kontribuan në ndërtimin e shtetit. “Kontributi i secilit prej tyre për lirinë dhe pavarësinë është i çmuar dhe historia do të jetë ajo që do ta bëjë gjykimin e drejtë”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se ky vit i pavarësisë e gjen Kosovën në fillim të mandatit të ri qeverisës, ndaj “punët janë të shumta”. “Mësuesë e studentë, mjekë e punëtorë, gra e burra, vajza e djem, të gjithë duhet të japim maksimumin tonë. Këtë e presin të gjithë. Le t'i bëjmë krenarë duke punuar e forcuar shtetin”, ka thënë Kurti.

Pavarësia e Kosovës është shpallur më 17 shkurt të vitit 2008 nga institucionet vendore, pas një periudhe të gjatë administrimi ndërkombëtar dhe negociatash për statusin.

Ajo është mbështetur fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumica e vendeve të Bashkimit Evropian. Që nga ajo kohë, Kosova ka bërë përparim në ndërtimin e institucioneve shtetërore, konsolidimin e sigurisë me mbështetjen e NATO-s dhe zgjerimin e njohjeve ndërkombëtare.

Megjithatë, shteti vazhdon të përballlet me sfida të mëdha, përfshirë kundërshtimet e

pavarësisë nga Serbia dhe disa vende të tjera, si dhe pengesa në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

FSK-ja dhe policia demonstrojnë kapacitetet në 18-vjetorin e Pavarësisë

Njësi të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës parakaluan më 17 shkurt në qendër të Prishtinës, në kuadër të ceremonive shtetërore për shënimin e 18-vjetorit të pavarësisë së vendit.

Parakalimi, i shoqëruar nga automjete ushtarake dhe pajisje të avancuara, pasqyroi përpjekjet për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë së vendit, si dhe gatishmërinë e institucioneve për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial.

Presidentja Vjosa Osmani, si komandante supreme e FSK-së, theksoi se pavarësia e Kosovës është rezultat i sakrificës dhe luftës për liri, duke nënvizuar se “pa kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pavarësia nuk do të ishte realiteti që festojmë sot”. Ajo ka thënë se përgjegjësi e brezit të sotëm është ta bëjë Kosovën më të drejtë për fëmijët dhe më të fortë për të ardhmen.





MBAHET MARSHI MË I MADH NË HISTORINË E KOSOVËS, NË MBËSHTETJE TË LIDERËVE TË UÇK-SË

POPULLI FOLI: DREJTËSI, JO POLITIKË - LIRI PËR ÇLIRIMTARËT

Dhjetëra - mijëra qytetarë kanë marrë pjesë në marshin “Drejtësi, jo politikë” të mbajtur në Prishtinë, në mbështetje të strategjeve të lirisë që po gjykojnë në Gjykatën Speciale në Hagë. Marshi është mbajtur në përvjetorin e 18-të të Pavarësisë së Kosovës. Organizatorët kanë përsëritur se thirrjet për drejtësi nuk janë kundër askujt, por për “dinjitetin kolektiv” të popullit të Kosovës

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 17 SHKURT - Dhjetëra - mijëra qytetarë në Ditën e Pavarësisë e kanë pasur destinacion Prishtinën për të protestuar dhe marshuar me moton “Drejtësi, jo politikë”, në mbështetje të liderëve të UÇK-së. Sheshet dhe rrugët kryesore të kryeqytetit ishin të stërmbyshura me qytetarë nga të gjitha komunat e Kosovës, rajoni, diaspora dhe përtej oqeanit. Prania masive, organizimi qytetar dhe mesazhi i qartë e kanë shndërruar këtë marsh në një moment historik të solidaritetit dhe qëndresës qytetare. Nga sheshet e “ngjeshura” të kryeqytetit janë dhënë pamje nga ajri për një fotografi të plotë kuqezi në mbështetje të UÇK-së dhe liderëve të saj që po gjykojnë në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Në këtë marsh ishte e pranishme edhe e presidentja Vjosa Osmani në rresht të parë me Endrit Thaçin, djalin e ish-presidentit Hashim Thaçin. Përpos Osmani kanë marrë pjesë edhe Ali Ahmeti, Bedri Hamza, Ramush Haradinaj, Taulant Balla, Përparim Rama dhe shumë personalitete të ndryshe nga jeta institucionale, politike, kulturore dhe akademike. Hapja e marshit “Drejtësi, jo politikë” është bërë me një videoprezentim ku janë nxjerrë fjalime të dëshmitarëve ndërkombëtarë të mbrojtjes si Wesley Clark e James Rubin për pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës. Pastaj është pasuar me këngë nga Ilir Shaqiri, këngëtari i çdokohshëm kombëtar. Organizatori i marshit nga platforma “Liria ka Emër”, Ismail Tasholli ka thënë se 17 Shkurti është jo vetëm festë, por edhe kujtesë e shpalljes së shtetit, lirisë dhe dinjitetit.

“Duhet ta themi qartë dallimin mes agresorit dhe viktimës. UÇK-ja nuk lindi për të marrë tokë të huaj por për ta mbrojtur tokën e vet. Kjo është e vërteta historike që nuk mund të ndryshohet”, ka thënë Tasholli. Më tutje, ai ka kërkuar drejtësi për liderët e UÇK-së, duke numëruar vrasjet, dëbimet dhe shtëpitë e djegura që janë bërë nga agresori gjenocidal nën udhëheqjen e Sllobodan Millosheviqit. “Sot në Hagë ndodhen ish-udhëheqësit e UÇK-së: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, emra që për shumëkënd përfaqësojnë kapituj të tërë të historisë sonë të rezistencës dhe shtetndërtimit. Pavarësisht proceseve gjyqësore, një gjë mbetet: lufta e UÇK-së ishte luftë çlirimtare dhe kjo nuk mund të zhbëhet kurrë, sepse historia jonë nuk është abstrakte, ajo ka shifra dhe dhimbje. Mbi 12 mijë qytetarë të vrarë e të masakruar. Mbi 1



RAMA TELEFONON THAÇIN PËR PAVARËSI, ISH-PRESIDENTI: UNË E KAM FITUAR PËRJETË LIRINË

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka publikuar një pjesë nga telefonata me ish-presidentin Hashim Thaçi në Hagë, të cilin e ka uruar për Ditën e Pavarësisë. “Jam shqetësuar shumë me këtë historinë, vëllai im të përqafoj fort, të du shumë. Më vjen shumë keq që s’bëj dot më shumë, po... Gëzuar dhe të përqafoj shumë fort dhe të fala atyre shokëve”, është dëgjuar teksa Rama i ka thënë Thaçit përmes telefonit.



600 persona ende të pagjetur, mbi 1 500 fëmijë nën moshën 18-vjeçare të vrarë. Mbi 20 mijë të mbijetuar të dhunës seksuale. Mbi 1 milion qytetarë të dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe mbi 500 mijë shtëpi të djegura, bashkë me shkolla, spitale e institucione. Mbi 3 mijë dëshmorë e mijëra të plagosur. Këto nuk janë vetëm statistika. Janë plagë të hapura, janë familje që presin, janë nëna që nuk dinë ku e kanë vajzën apo djalin, janë fëmijë që u rritën pa prindër, janë gra që mbajnë dhimbjen si barrë të heshtur, janë qytete të tëra që u zbrazën me dhunë”, ka thënë Tasholli.

Në këtë marsh ka folur edhe e

Rama ka ndarë edhe mesazhin emocional që ka thënë se ish-presidenti Thaçi e ka përsëritur. “Prej vitesh telefonata e urimit të 17 shkurtit nga Haga është e vështirë emocionalisht, por sot komandanti ishte si asnjëherë i qetë në zërin e tij, duke ma përsëritur dy herë, në fillim e në fund: ‘unë e kam fituar përjetë lirinë dhe kudo të ndodhem atë nuk ma merr dot kurrë askush!’, ka shkruar Rama në “Facebook”.

mbijetuara e mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi. Ajo ka thënë se 17 shkurti përveç festes që shënon përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, shënon edhe brengën për drejtuesit e UÇK-së që po gjykohej në Hagë. Para mijëra shqiptarëve nga të gjitha trojet shqiptare, ajo ka kërkuar atë që populli do: lirinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ndërsa ish-luftëtarja e UÇK-së, Shqipe Krasniqi ka thënë se gjykimi në Hagë që po bëhet ndaj krerëve të UÇK-së është dhimbje që prekë sakrificën e çdo qytetari shqiptarë. Krasniqi ka kujtuar fjalimin e ish-

MARSHI NË MBËSHTETJE TË STRATEGËVE TË LIRISË: MAVRAJ: MESAZHI I KOMBIT MORI UDHË...



Prishtinë, 17 shkurt - Publicisti dhe një Muhamet Mavraj, ka thënë se protesta/marshi në mbështetje të strategëve të lirisë ka qenë më e madhja që është organizuar ndonjëherë në Kosovë. Ai ka thënë se në këtë marsh ka marrë udhë mesazhi i kombit shqiptar. “Ishte më e madhja e ndonjëherit. Dinjitoze dhe madhështore. Mesazhi i kombit mori udhë...”, ka shkruar Mavraj në “Facebook”. Para kësaj proteste, Mavraj ka bërë thirrje për pjesëmarrje masive. Ai ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë është duke u shërbyer me dosje të pushtesit të Kosovës. “Dalim sot të gjithë për mbrojtjen e shtetit dhe themeluesve të tij! Gëzuar 17 shkurtin! Siç e kemi thënë shpesh, Prokuroria e Hagës, duke u shërbyer me dosjet e pushtesit tonë, ka treguar se për atë interes do të shërbehej pa u skuqur me dosje naziste kundër hebrejve dje dhe me dosje ruse kundër ukrainasve nesër. Nuk jam çuditur që me emër dhe mbiemër edhe Adem Jasharin e trajtojnë kriminel, siç e thanë disa herë, edhe ndalimin e 8 ushtareve serbë të armatosur si shkelje ligji dhe një faj – një krim në kohë lufte! Ata prokurorë janë trimëruar nga



fushatat propagandistike të vjetra e të reja kundër krerëve të lirisë dhe shfaqjen e urrejtjes patologjike pas shpalljes se shtetit të Kosovës. Ne i dimë rrënjët e kësaj lufte kundër lirisë

sonë! Sot është një nga ditët e mëdha për ta regjistruar veten në tubim kombëtar kundër padrejtësisë në Hagë dhe tjerave këtupari!”, ka shkruar Mavraj.

presidentit Hashim Thaçi, i cili para se të shkonte në Hagë kishte thënë “..kjo nuk është lamtumirë, por një mirupafshim”. Në fund të marshit “Drejtësi, jo politik”, Lirim Haziri, i biri i Xhavit Hazirit, bashkëthemelues i Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, i zhdukur që nga viti 1998, ka thënë se nuk ka një varr ku mund të vendos lule për babain e tij, por ka një zë që harresa mos të ketë vend në mesin e shqiptarëve. Ai ka thënë se lufta e UÇK-së ishte luftë për mbijetesë dhe dinjitet kombëtar: “17 Shkurti nuk

është vetëm festë, është betim. Betim që nuk harrojmë sakrificën”, ka thënë Haziri, duke shtuar se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë duke vazhduar betejën për Kosovën larg familjeve. Pas fjalimeve, marshi “Drejtësi, jo politikë” ka përfunduar pas asnjë incident.





**“Liria ka Emër”:
Mbi 130 mijë qytetarë në
marshin “Drejtësi,
jo politikë”, marshimi më
i madh në historinë e
Kosovës së lirë**

Platforma “Liria Ka Emër” ka njoftuar se mbi 130 mijë qytetarë kanë marrë pjesë në marshin “Drejtësi, jo politikë”, në mbështetje të liderëve të UÇK-së që po gjykohen në Hagë. Në njoftimin e kësaj platforme është theksuar se “sipas vlerësimeve të ekspertëve dhe të dhënave nga terreni, mbi 130 mijë qytetarë morën pjesë sot në marshin ‘Drejtësi, jo politikë’, në mbrojtje të çlirimtarëve Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarëve të tyre, duke e bërë atë marshimin më

të madh në historinë e Kosovës së lirë”. “Sheshi dhe rrugët kryesore të Prishtinës ishin të stërmbushura me qytetarë nga të gjitha komunat e vendit, nga rajoni, diaspora dhe përtej oqeanit. Prania masive, organizimi qytetar dhe mesazhi i qartë e shndërruan këtë marsh në një moment historik të solidaritetit dhe qëndresës qytetare”, ka njoftuar platforma “Liria ka Emër”.

Lidhur me pjesëmarrjen në marshin “Drejtësi, jo politikë” është pyetur edhe “ChatGPT”-ja. Sipas ChatGPT-së në këtë marsh kanë marrë pjesë mbi 250 mijë protestues.

**Marshi “Drejtësi,
jo politikë” në titujt e
medieve kryesore
ndërkombëtare**

Prishtina është shndërruar në

skenë qendrore të lajmeve ndërkombëtare teksa mijëra qytetarë kanë marshuar nën moton “Drejtësi, jo politikë”, në përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në qendër të kryeqytetit, nën flamujt kuqez dhe simbolet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, protesta në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohen në Hagë u raportua gjerësisht edhe nga shtypi botëror. Agjencia e lajmeve “Reuters” ka shkruar se si marshimi në kryeqytet është bërë nën simbolet e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës dhe me një pjesëmarrje masive, duke e shndërruar Prishtinën në epiqendrën e mobilizimit popullor në mbështetje të udhëheqësve të UÇK-së. Artikulli e ka vendosur protestën në kontekstin e gjykimit që po zhvillohet në Hagë, ku krerët e lartë politikë dhe ushtarakë të Kosovës

përballen me akuza për krime lufte.

Duke raportuar nga terreni, “Reuters” ka shkruar: “Mijëra njerëz u mbledhën në Prishtinë të martën, duke mbajtur pankarta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të shqiptarëve etnikë, për të protestuar kundër gjyqit ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, përfshirë një ish-president, të akuzuar për krime lufte gjatë luftës së viteve 1998-99 për pavarësi.”

Tutje, “Reuters” ka sjell në vëmendje se “ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputeti Rexhep Selimi u arrestuan në vitin 2020 dhe u dërguan për t’u përballur me gjyq në gjykatën e posaçme për krime lufte për Kosovën në Hagë.”

Artikulli ka rikujtuar se gjykata në Hagë ndodhet në fazën

përfundimtare të procesit.

Ndërsa “France24” e ka vendosur protestën në të njëjtin kontekst, duke shkruar se tubimi është mbajtur pikërisht në Ditën e Pavarësisë dhe “pak para seancës përfundimtare në gjyqin ndaj ish-presidentit dhe liderit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, së bashku me tre figura të larta të lëvizjes guerile”.

Televizioni francez ka raportuar se nga ajri shiheshin turma që mbushnin sheshin kryesor dhe rrugët përreth, ndërsa është vlerësuar se në protestë kanë marrë pjesë “dhjetëra mijëra” qytetarë, me organizatorët që flasin për mbi 200 mijë të pranishëm. “France24” ka theksuar flamujt e kuq me stemën e verdhë e të zezë të UÇK-së dhe thirrjet e turmës që brohoriste UÇK-së e teksa marshonte në qendër të Prishtinës.



MË 27 SHKURT, DEKLARATAT HYRËSE PËR THAÇIN DHE TË TJERËT NË RASTIN PËR 'PENGIM TË DREJTËSISË'

HAGË, 17 SHKURT - Dhomat e Specializuara në Hagë kanë bërë me dije se më 27 shkurt do të mbahen deklaratat hyrëse në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në rastin për "pengim të drejtësisë".

Ata akuzohen se, gjatë periudhës prill-nëntor 2023, kanë ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria për çështjen gjyqësore për krime lufte "Thaçi dhe të tjerët". Aktakuza e konfirmuar nga gjykata më 29 nëntor, 2024, thekson se Thaçi u dha informacione konfidenciale bashkëpunëtorëve të tij dhe i udhëzoi ata për të ndërhyrë në dëshmitë e dëshmitarëve. Të pesë të akuzuarit janë vetëdeklaruar të pafajshëm.

Pas deklaratave hyrëse, prokuroria do të fillojë prezantimin e provave të saj. Thaçi, ish-president i Kosovës,

akuzohet edhe kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, së bashku me tre ish-eporë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Në këtë rast, nga java e kaluar, janë duke u zhvilluar deklaratat përmbyllëse, gjatë të cilave mbrojtja argumentoi se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për krimet e pretenduara, ndërsa Prokuroria kërkoi që të katërtit të shpallen fajtorë. Pas përmbylljes së deklaratave, çështja do të kalojë te trupi gjyqësor, i cili ka afat tre muaj për të marrë një vendim ose mund të kërkojë zgjatjen e këtij afati.

Njoftimi ka ardhur në ditën kur Kosova shënon 18-vjetorin e pavarësisë, ndërsa pritet edhe një protestë që do të adresojë, sipas organizatorëve, trajtimin e padinjitetshëm të të akuzuarve në Hagë.



WALKER PËR LIDERËT E UÇK-SË: JANË TË PAFAJSHËM, MBAJTJA LARG FAMILJEVE ËSHTË PADREJTËSI E TMERRSHME

PRISHTINË, 17 SHKURT - Ish-diplomati amerikan, William Walker, ka kritikuar procesin gjyqësor ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë, duke e cilësuar atë të tej zgjatur dhe problematik nga pikëpamja e drejtësisë. Ai ka thënë se gjyqi ka zgjatur mbi 10 vjet dhe është shoqëruar me rotacion të shumtë juristësh, prokurorësh dhe gjyqtarësh ndërkombëtarë. Sipas tij kushtet komode të jetesës në Hagë, pagat e larta dhe përfitimet shtesë mund të kenë ndikuar në zvarritjen e procesit, duke shtuar se disa prej zyrtarëve nuk kanë pasur interes që gjyqi të mbyllet shpejt. "Gjyqi në Hagë po zhvillohet për 10 vjet. Numri i juristëve, gjyqtarëve, prokurorëve ndërkombëtarë janë përfshirë dhe kanë ikur nga Haga mbas një periudhe kohore që kanë qenë aty. Shumë prej tyre kanë qenë aty në këtë çështje për vite me radhë dhe të jetosh në Hagë është një vend shumë komod për të jetuar. Të gjithë facilitetet e jetës moderne janë aty. Hotele shumë të mira, restorante shumë të mira, pagat që ato marrin janë të mira. Ka shtesa gjithashtu të pagës që marrin jo të gjithë, por mendoj që disa prej tyre nuk do të dëshironin. Nuk kanë dëshiruar që ky gjyq të përfundojë, sepse pothuajse



një dekadë e karrierës së tyre të punojnë në Hagë, të marrin pjesë në hetime dhe pastaj ndjekja penale e këtyre personave të akuzuar. Kanë jetuar një jetë shumë komode dhe më vjen shumë inat kur e mendoj këtë gjë, por duke pasur parasysh kushtet në Hagë, duke pasur parasysh akomodimin, pagat e mira dhe shtesat dhe të jesh një prokuror, apo një gjyqtar në Gjykatën ndërkombëtare të

Hagës. Besoj se kjo ka ndikuar gjithashtu në kohëzgjatjen e këtij procesi", ka thënë ai për "A2 CNN".

Duke sjellë në vëmendje gjyqet e Nuremberg, të cilat, sipas tij, kanë përfunduar brenda dy deri në tre vite pas Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht shkallës shumë më të madhe të krimeve, Walker ka thënë se do të donte që të ishte ndjekur i njëjti standard edhe në këtë rast. "Unë kam qenë një i

interesuar, kam pasur më shumë interes historinë dhe marrëdhënie ndërkombëtare të viteve të fundit të viteve 40 kur u zhvillua gjyqi, kur u zhvilluan gjyqet e Nurembergut. Dhe këto gjyqe ishin për të dënuar pra krimet e Luftës së Dytë Botërore dhe kur gjermanët dhe të tjerë kryen krime të tmerrshme lufte në shkallë të paimagjinueshme miliona njerëz të vrarë si rezultat i

krimeve të luftës dhe gjyqi i Nurembergut zgjati nga 1945 fundi i luftës 1948 pra dy deri në tre vite, krahasuar me 10 vite në këtë rast, ishte një proces i drejtë. Shumë nga të pandehurit u gjendën të pafajshëm do të doja që këto standarde të sjelljes nga gjykata të ishin ndjekur dhe në këtë rast dhe në këtë çështje", ka thënë ai. Walker ka theksuar se mbajtja e të akuzuarve në paraburgim pa një vendim përfundimtar bie ndesh me parimin bazë të drejtësisë. Sipas tij është e padrejtë që të akuzuarit kanë humbur vite të tëra të jetës larg familjeve të tyre pa një vendim të formës së prerë. "Të mbash të akuzuarit të ndaluar në paraburgim për katër vjet pa pasur qasje në botën e jashtme... Zotit Thaçi i është dhënë vetëm një ditë nga paraburgimi për të shkuar në vdekjen dhe ceremoninë funerale të babait të tij, një ditë nga katër vjet. Për mendimin tim, shprehja i pavarur derisa të provohesh i fajshëm është parimi bazë i drejtësisë, sistemit të drejtësisë. Këto persona deri më tani janë të pafajshëm, derisa të provohet fajësia e tyre dhe gjithsesi ata kanë humbur katër vjet nga jeta e tyre. Katër vjet larg familjes së tyre dhe kjo mendoj është një padrejtësi e tmerrshme", ka thënë Walker



MARSHI 'DREJTËSI JO POLITIKË'

REUTERS: PROTESTUAN MIJËRA PERSONA, SHUMË PREJ TYRE MBANIN UNIFORMËN E UÇK-së

PRISHTINË, 17 SHKURT - Kryeqyteti i Kosovës u mbush sot me mijëra qytetarë në një nga mobilizimet më të mëdha publike të viteve të fundit, në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po përballen me gjykimin në Hagë (The Hague). Marshi për Drejtësi, i organizuar në Prishtinë, u shndërrua në një manifestim masiv solidariteti me Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, në kohën kur në procesin gjyqësor ndaj tyre po zhvillohen deklaratat përmbyllëse dhe prokuroria ka kërkuar dënime deri në 45 vjet burgim për secilin.

Protesta e sotme, e cila mbledhi qytetarë nga të gjitha anët e vendit dhe rajonit, u pasqyrua edhe nga agjencia ndërkombëtare Reuters, duke theksuar pjesëmarrjen masive dhe momentin kritik në të cilin ndodhet procesi gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së.

RAPORTIMI I REUTERS:

Mijëra persona në Kosovë protestojnë kundër gjyqit për krime lufte ndaj ish-komandantëve të UÇK-së – Mijëra vetë u mbledhën të martën në Prishtinë duke mbajtur pankarta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), për të protestuar kundër gjyqimit të

ish-udhëheqësve të UÇK-së, përfshirë një ish-president, të akuzuar për krime lufte gjatë luftës për pavarësi të viteve 1998–99.

Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryetarët e Kuvendit Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi u arrestuan në vitin 2020 dhe u dërguan për t'u përballur me gjyqin në gjykatën speciale për krime lufte të Kosovës në Haga.

Thaçi dhe tre ish-komandantë të tjerë të UÇK-së akuzohen për përndjekje, vrasje, torturë dhe zhdukje me forcë të personave gjatë dhe menjëherë pas kryengritjes së viteve 1998–99, e cila përfundimisht solli pavarësinë për rajonin me shumicë shqiptare nga Serbia. Ata i mohojnë të gjitha akuzat. Këtë javë gjykata po dëgjon argumentet përmbyllëse në proces, përpara se gjyqtarët të

japin një vendim përfundimtar brenda tre muajsh. Prokurorët po kërkojnë një dënim prej 45 vitesh për secilin.

"Ata që e meritojnë të jenë në Hagë janë pushtuesit, jo çlirimtarët," tha Miran Zeka, 49 vjeç, i cili kishte ardhur nga Shqipëria për të protestuar në Prishtinë.

"Ne luftuam në tokën tonë, nuk shkuam në Serbi për të luftuar," tha Bekim Muja, 53 vjeç, veteran

i luftës së Kosovës 1998–99.

Shumë protestues mbanin uniforma të UÇK-së, ndërsa të tjerë valëvitnin flamuj të UÇK-së, të Kosovës dhe të Shqipërisë. Mbështetësit mbanin pankarta me mbishkrimin "Liria ka emër" dhe fotografi të Thaçit dhe të tjerëve me shkrimin "Heronj të Luftës dhe Paqes".

Thaçi, 57 vjeç, shërbeu si kryeministër, ministër i Jashtëm dhe president i Kosovës së pavarur midis viteve 2008 dhe 2020.

Më shumë se 13,000 persona, shumica prej tyre shqiptarë të Kosovës, besohet se kanë humbur jetën gjatë kryengritjes së fundviteve 1990, kur Kosova ishte ende një krahinë e Serbisë nën presidentin e atëhershëm nacionalist Slobodan Milošević, trupat e të cilit shtypën me dhunë shqiptarët etnikë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, të përbëra nga gjyqtarë dhe avokatë ndërkombëtarë, u krijuan në vitin 2015 për të trajtuar rastet e krimeve të luftës sipas ligjit të Kosovës kundër ish-luftëtarëve të UÇK-së. Tribunali për krime lufte u ngrit jashtë vendit të vogël ballkanik për shkak të shqetësimeve për frikësimin e dëshmitarëve, pasi ish-udhëheqësit e UÇK-së shihen nga shumëkush në Kosovë si heronj të çlirimit kombëtar.



AUTORITARIZMI ‘I ZGJUAR’ I KINËS: SI U BË LIDER NË INOVACION, PAVARËSISHT REPRESIONIT

Nga Luca ANGELINI –
Corriere della Sera

Nëna e të gjitha parashikimeve të gabuara për Kinën është se duke u bërë më i pasur, gjigandi aziatik do të bëhej edhe më demokratik. Teoria “Wandel durch Handel” apo “ndryshim përmes tregtisë”, u transportua nga epoka sovjetike në botën pas Luftës së Ftohtë. Duke u bërë më e pasur, Kina në vend që të bëhej më demokratike, e gjeti veten me një president si Xi Jinping, jo më pak autoritar dhe ndoshta edhe më të fuqishëm se Mao Ce Duni. Megjithatë, ka edhe një parashikim tjetër që është i përhapur: se institucionet autoritare të vendit komunist, duke shtypur inovacionin përmes represionit, censurës dhe korrupsionit, po e pengojnë në mënyrë të pashmangshme Kinën të konkurojë realisht me Shtetet e Bashkuara teknologjikisht, duke e bërë kështu të pamundur edhe kërcënimin e supremacisë së saj ekonomike dhe ushtarake.

Lidershipi i Kinës

Jennifer Lind, një profesoreshë në Kolegjin Dartmouth dhe një bashkëpunëtorë në Chatham House, i ka kushtuar një libër të tërë (Autokracia 2.0. Si e rishpiku rilindja e Kinës tiraninë) për të hedhur poshtë këtë parashikim. Ajo i përmbledh tezat e saj në një artikull në Foreign Affairs. Ajo fillon me një vëzhgim: duke sfiduar parashikimin e lartpërmendur, Kina është bërë një lider global në inovacion. Kompanitë kineze dominojnë sektorë të teknologjisë së lartë si automjetet elektrike, bateritë e përparuar, energjia e rinovueshme dhe telekomunikacioni. Pekini tani po konkurren për të marrë lidërsipin e inteligjencës artificiale, superkompjuterët dhe shkencën kuantike, teknologjitë që do të mbështesin produktivitetin dhe fuqinë ushtarake të së ardhmes.

“Autoritarizmi i zgjuar”

Si e bëri ajo këtë? Duke aplikuar atë që Lind e quan “autoritarizëm i zgjuar”. Nga çfarë përbëhet? Duke aplikuar shtypjen dhe censurën në doza të llogaritura me kujdes, të cilat na lejojnë të shpëtojmë nga dilema e regjimeve autoritare. Kontrolli politik dhe shoqëror mund të qëndrojnë dhe ndërkohë mund të ngrihet një ekonomi inovative. Megjithatë, të paktën nga një pikë e caktuar e tutje, dhe jo të dyja. Sepse dihet që edhe një regjim joliberal dhe autoritar mund të

shkaktojë një proces rritjeje duke përfituar nga avantazhi konkurrues i punës me kosto të ulët. Por për të shmangur “kurthin e të ardhurave të mesme”, në një pikë të caktuar është e domosdoshme të rritet produktiviteti përmes inovacionit. Këtu hasim dilemën e lartpërmendur, të cilën shkencëtari politik Samuel Huntington e quajti “dilema e mbretit”: Një regjim mund të mbajë një kontroll të fortë mbi shoqërinë, por duke vepruar kështu do të shtypë inovacionin dhe rritjen. Nga ana tjetër, ai mund të lejojë një rrjedhë më të lirë informacioni dhe të inkurajojë kreativitetin dhe dinamizmin, por kjo mund ta hapë shoqërinë ndaj burimeve alternative të ndikimit dhe pushtetit që mund ta kërcënojnë regjimin.

Modeli i Singaporit

Ky dukej të ishte mësimi i nxjerrë nga Tajvani dhe Koreja e Jugut. Shpëtimi nga varfëria filloi nën qeveritë autoritare, por demokratizimi ishte i nevojshëm për t’u bërë ekonomi të përparuar. Megjithatë, në Pekin, ata studiuin një model tjetër: atë të Singaporit. Një qytet-shtet që ka një teknologji të lartë, ku autoritarizmi nuk është zhdukur me zhvillimin. Shumica e politikanëve dhe ekonomistëve do të kishin kundërshtuar që receta për një entitet kaq të vogël mund të funksiononte në një vend kaq të madh. Megjithatë, brenda Partisë Komuniste Kineze, që nga koha e Deng Xiaopingut, ata janë bindur. “Singapori do të ishte një histori e vogël, në fund të fundit, nëse nuk do të ishte modeli që Kina aspiroin gjithashtu”, – shkruan Battaglia. Lind përmbledh atë që ndodhi në këtë pikë: “Që nga reformat e Deng, qeveria kineze ka krijuar një fuqi punëtore shumë të kualifikuar duke investuar shumë në arsimin e lartë elitar”.

Arsimi dhe ekspertiza

Sot, Kina është një lider botëror në trajnimin e inxhinierëve dhe doktoraturës në shkencë dhe inxhinieri. Universitetet e saj kanë fituar 8 nga 10 pozicionet e para në Renditjen Botërore të Universiteteve 2025 sipas listës së përpiluar nga Universiteti Leiden. Partia Komuniste Kineze ka profesionalizuar gjithashtu administratën publike, duke zbatuar provime të rrepta licencimi dhe duke i dhënë përparësi kompetencës mbi njohuritë. Qeveria ka përmirësuar gradualisht mbrojtjen e të drejtave të pronës dhe ligjin



tregtar. Gjatë periudhës së reformave të Jiang Zemin (1989–2002), Partia Komuniste Kineze mundësoi zgjerimin e medias, kompanive të sektorit privat dhe organizatave jofitimprurëse. Një shoqëri civile më e gjerë jo vetëm që ka stimuluar rritjen ekonomike, por ka mundësuar përhapjen e ideve dhe ka forcuar edhe partinë, siç vëren analistja politike Jessica Teets. Duke vepruar si burim informacioni mbi problemet sociale dhe duke promovuar reforma politike që kanë forcuar kontrollin e regjimit mbi pushtetin.

Regjimi nuk hoqi kurrë dorë nga kontrolli

A është bërë regjimi komunist më pak autoritar? Jo. Më mirë të themi se ai ka mësuar ta zbatojë autoritarizmin në mënyrë më inteligjente. “Regjimi nuk e ka hequr kurrë dorë nga kontrolli mbi shoqërinë civile. Partia përdor monopolin e saj mbi pushtetin për të drejtuar programet e kërkimit drejt temave të përputhura me objektivat shtetërore, për të kufizuar debatin publik mbi politikat dhe për të paracaktuar vendimet gjyqësore nëse beson se stabiliteti shoqëror ose reputacioni i saj janë në rrezik. Për më tepër, ajo monitoron me rigozitet individët, kompanitë dhe organizatat joqeveritare dhe lejon vetëm ata që i përmbahen rregullave të veprojne.”

Një represion me “Intensitet të ulët”

Nëse ka ndonjë gjë, partia ka “kaluar nga represioni me intensitet të lartë në atë me intensitet të ulët” (duke marrë parasysh persekutimin brutal të disidentëve si fituesi i Çmimit

Nobel për Paqen Liu Xiaobo, i cili vdiq në vitin 2017 pas një dënimi të gjatë me burg dhe botuesit nga Hong Kongu Jimmy Lai, i cili u dënua së fundmi me 20 vjet burg apo shtypjen në Tibet dhe kundër ujqurëve të Xinjiang). “Shtypja e përgjakshme në Sheshin Tiananmen në vitin 1989”, – shpjegon Lind, “e kishte vënë represionin e PKK-së në qendër të vëmendjes globale dhe kishte dekurajuar investimet e huaja në Kinë. Që atëherë, partia ka aplikuar metoda më të studiara për të kufizuar kundërshtarët vendas. Siç zbulon shkencëtari politik Rory Truex, Pekini monitoron nga afër disidentët dhe qytetarët e pakënaqur për t’i parandaluar ata të bashkohen në protesta, mban një “kalendar disidentësh” për të ndaluar paraprakisht aktivistët në përvjetorët e rëndësishëm dhe rekruton anëtarë të familjes për të ushtruar presion mbi protestuesit që të heqin dorë. Kur regjimi e konsideron të nevojshme të përdorë dhunën, si për shembull, kur dëshiron të dëbojë me forcë fermerët nga një tokë ku synohet të ngrihet një nga projektet e zhvillimit, ai ua jep forcën “kriminelëve me pagesë” për t’u distancuar nga sulmet, siç argumenton studiuesja Lynette Ong. Falë investimeve masive në inteligjencën artificiale, veçanërisht njohjen e fytyrës dhe sistemeve të tjera biometrike, PKK mund të mbështetet më shumë te teknologjia sesa te shkopinjët për të kontrolluar popullsinë.

Përshtatja e “Levave të kontrollit”

Qëndrimi në dukje i lëkundur dhe kontradiktor i partisë ndaj sektorit të teknologjisë (sulmi i vitit 2020 ndaj Jack Ma dhe

bashkëpunëtorëve të tij u pasua nga një simpozium në shkurt 2025 për të demonstruar mbështetjen e PKK-së për sipërmarrësit në këtë sektor) mund të shpjegohet me faktin se “autoritarizmi i zgjuar” kërkon përshtatje dhe korrigjim të vazhdueshëm. “Autoritarizmi i zgjuar nuk është një strategji që synon maksimizimin e rritjes. Udhëheqësit janë të vetëdijshëm se, përmes përpjekjeve të tyre për të ruajtur kontrollin, ata po lënë një pjesë të rritjes ekonomike në tryezë. Por, teksa një hapje dhe liri më e madhe mund të përkthehet në inovacion më të madh dhe rritje më të shpejtë, kjo rrezikon të vijë me koston e humbjes së pushtetit. Ekuilibri midis lirisë dhe kontrollit ndryshon bazuar në opinionin publik, fazën ekonomike të zhvillimit, evolucionin e teknologjive dhe metodave të kontrollit, si dhe nxitësit e rritjes dhe inovacionit. Udhëheqësit e zgjuar autoritarë duhet të përshtasin vazhdimisht levat e kontrollit për të hapur shoqërinë kur munden dhe për të shtrënguar kontrollin e tyre kur duhet. Kur arrijnë të gjejnë ekuilibrin e duhur, inovacioni mund të lulëzojë edhe në mungesë të institucioneve gjithëpërfshirëse. Duke kundërshtuar kështu parashikimet (madje edhe të fituesve të Çmimit Nobel në Ekonomi si Daron Acemoglu dhe James Robinson, të cilët identifikojnë institucionet gjithëpërfshirëse, në vend të atyre nxjerrëse, si rrënjën e suksesit ekonomik të kombeve), gjigantët me emra tani të njohur globalisht, si BYD, Huawei, ByteDance, Alibaba – dhe startup-e të habitshme si DeepSeek, janë aty për ta vërtetuar këtë.

SHBA-IRAN: MES NEGOCIATAVE, FORCËS USHTARAKE DHE EKZEKUTIMEVE TË REJA

Tensioni mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit po hyn në një fazë të re, ku diplomacia dhe përgatitjet ushtarake ecin paralelisht, pothuajse në të njëjtin ritëm. Ndërsa bisedimet për programin bërthamor iranian rifillojnë në tryezat diplomatike, në sfond po zhvillohet një demonstrim i qartë force që tregon se mundësia e konfliktit nuk është aspak teorike.

Në Lindjen e Mesme, çdo lëvizje interpretohet si sinjal strategjik. Dislokimi i avionëve luftarakë, prodhimi i bombave anti-bunker dhe deklaratat e forta politike tregojnë se palët po përgatiten njëkohësisht për dy skenarë të kundërt: një marrëveshje historike... ose një përplasje që mund të ndryshojë ekuilibrat rajonalë. Negociata nga njëra anë, demonstrim force nga ana tjetër. Shtetet e Bashkuara dhe Irani rikthehen në tryezën e bisedimeve me synime të mira për paqe, por edhe me lëvizje strategjike që përgatisin luftën — një konflikt për të cilin do të vendoset “në javët e ardhshme, jo në muajt e ardhshëm”, sipas senatorit republikan Lindsey Graham, gjatë një vizite në Izrael. Në prag të raundit të dytë të bisedimeve sot në Gjenevë, në selinë e ambasadës së Omanit, mes të dërguarve amerikanë Steve Witkoff dhe Jared Kushner nga njëra anë dhe ministrit të Jashtëm iranian Abbas Araghchi nga ana tjetër, Komanda Qendrore e Forcave të Armatosura amerikane në Lindjen e Mesme (Centcom)



publikoi imazhe të avionëve luftarakë stealth të gjeneratës së pestë F-35C VMFA-314, të quajtur “Kalorësit e zinj”, të projektuar për të depërtuar mbrojtjen ajrore armike dhe për të kryer sulme precize. Së bashku me ta janë edhe Boeing EA-18G Growler, të specializuar në sulme elektronike dhe neutralizimin e mbrojtjes kundërshtarë. Fotografitë tregojnë përgatitjet për ngritje nga aeroplanmbajtësja Lincoln. Një sinjal i qartë, që i shtohet edhe një zhvillimi tjetër vendimtar. Forcat Ajrore amerikane i kanë porositur Boeing-ut bomba të reja “bunker buster”, GBU-57 me peshë 13.600 kilogramë, pasi kanë shteruar rezervat e tyre — plot 14 të përdorura gjatë luftës 12-ditore të qershorit të kaluar për të goditur objektet

bërthamore iraniane. Përgatitjet për një konflikt të ri nuk ndalen, pavarësisht “shpresës” së Shteteve të Bashkuara për të arritur një marrëveshje dhe pavarësisht se Irani e quan “më realiste” qëndrimin amerikan për çështjen bërthamore. Drejtori i Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA), argentinasi Rafael Grossi, ka zhvilluar “bisedime të thelluara” me ministrin iranian Araghchi, ndërsa Irani ka njoftuar se inspektorët e agjencisë do të mund të kontrollojnë objektet e tij “për të treguar se nuk po kërkon armë bërthamore”.

SHBA-Iran, marrëveshja pothuaj e pamundur

Por arritja e një marrëveshjeje

diplomatike që “të adresojë çështjet shqetësuese” për SHBA-në mbetet “e vështirë”, sipas sekretarit amerikan të Shtetit Marco Rubio. Nëse Teherani është i gatshëm për lëshime në programin bërthamor dhe rezervat e uranimit të pasuruar, nuk pranon të tërhiqet asnjë milimetër nga programi i raketave dhe ka përsëritur se nuk do të negociojë për këtë, sepse “bëhet fjalë për sigurinë kombëtare”. “Nuk do t’u nënshtrohemi kërcënimeve të SHBA-ve”, thotë Araghchi, duke shtuar se ka ardhur në Gjenevë “për të arritur një marrëveshje të drejtë dhe të balancuar”. Mes dy palëve mbetet një hendek i madh edhe për vetë objektin e negociatave: Irani kërkon që ato të kufizohen vetëm te çështja bërthamore,

ndërsa Shtetet e Bashkuara duan t’i zgjerojnë për të përfshirë raketat, mbështetjen për grupet terroriste në rajon dhe shtypjen e protestuesve iranianë, të cilët janë vlarë me mijëra pasi dolën në rrugë kundër diktaturës. Regjimi nuk ndalet në përdorimin e forcës. Sipas organizatës Hrana, në dy ditët e fundit janë ekzekutuar 17 persona dhe dje, në seksionin 15 të Gjykatës Revolucionare, janë dhënë 14 dënime me vdekje ndaj protestuesve të janarit, në procese farsë të zhvilluara online. Ata që i mbijetuan plumbave, tani rrezikojnë jetën nga “drejtësia” e regjimit. Kreu i gjyqësorit, Gholamhossein Mohseni-Ejei, u ka bërë thirrje autoriteteve të “ndëshkojnë rebelët pa asnjë mëshirë”. / bota.al

Një model rritjeje ende në krizë

Le të jemi të qartë, nuk do të thotë që modeli ekonomik kinez është pa të meta dhe dobësi. Në faqen e internetit të Foreign Affairs, mund të lexoni analizën e Dinny McMahon (“Modeli i rritjes së Kinës është ende në krizë”), e cila thotë se “Kina nuk po e ribalancon ekonominë e saj drejt konsumit. Kjo nuk do të thotë se nuk dëshiron më shumë konsum. Përkundrazi. Udhëheqësit e Pekinit kanë mbështetur publikisht nevojën për ta rritur atë. Në shkurt 2025, kryeministri kinez Li Qiang bëri thirrje për “rritje të konsumit për të zgjeruar kërkesën e brendshme, për të zbutur ciklin ekonomik dhe për të stimuluar rritjen”. Por udhëheqësit kinezë presin që rritja e konsumit të

ndodhë në fund të tranzicionit ekonomik të Kinës, jo në fillim. Në vend që të rishpërndajë pasurinë në mënyrë që njerëzit të mund të shpenzojnë më shumë, Pekini dëshiron të përqendrohet në krijimin e pasurisë së re me shpresën se kjo do të stimulojë konsum më të madh në të ardhmen. Në planin afatgjatë, kjo qasje mund të çojë në një model rritjeje më të ekuilibruar. Megjithatë, përballë kërkesës së dobët të brendshme që rezulton nga shpërthimi i flluskës së pasurive të paluajtshme, Kina po rrit më tej eksportet e saj në planin afatshkurtër. Kjo jo vetëm që vonon kalimin e Kinës drejt konsumit, por gjithashtu premtion shkatërrim të pasurisë për vendet e tjera që kërkojnë të konkurrojnë me Kinën ose të gjejnë vendin e tyre në ekonominë globale.

Një model që të tjerët mund ta imitojnë

Sidoqoftë, rritja e “autoritarizmit dinak” me karakteristika kineze nuk është lajm i mirë për jo-autoritarët. Së pari, sepse, edhe nëse sistemi kinez, siç u përmend më sipër, nuk është pa të meta, ndoshta duhet të “supozohet se Kina do të mbetet një fuqi e fuqishme ekonomike, teknologjike, diplomatike dhe ushtarake”, madje edhe më e rëndë se Bashkimi Sovjetik. Dhe së dyti, sepse “PKK-ja ndan teknologjitë e saj të kontrollit me autokratë në të gjithë botën, përfshirë Egjiptin, Etiopinë dhe Iranin, dhe shpesh trajnon zyrtarët në ato vende me metodat e sundimit autoritar. Suksesi i autoritarizmit dinak të Kinës ofron një model tërheqës

për udhëheqësit në vende si Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Vietnami për t’u imituar”. Nga të gjitha eksportet e Kinës, ky është padyshim ndër më të dëmshmit.

Çfarë mund të bëjnë sistemet demokratike?

A na mbetet të dorëzohemi? Sipas Lind, jo. Sepse shoqëritë e hapura dhe sistemet demokratike ende kanë disa përparësi, edhe nëse ndonjëherë duket se i harrojnë ato. “Shtetet e Bashkuara nuk mund të presin thjesht që Kina dhe regjimi i saj autoritar të ndjekin shembullin sovjetik dhe të zhduken në harresë. Në të vërtetë, duke përgënjeshtuar arrogancën perëndimore, regjimet e zgjuara autoritare kanë provuar të jenë

të adaptueshme dhe kompetente. Për t’u përballur me sfidën e një Kine inovative, Shtetet e Bashkuara duhet të mbështeten në pikat e forta që e kanë bërë atë një fuqi teknologjike: institucione arsimore të klasit botëror (me talente tërheqëse të huaja), tregje financiare të rregulluara mirë dhe të forta, leadership financiar global, një kulturë të fortë sipërmarrëse, një shoqëri civile të gjallë dhe një pozicion unik në qendër të rrjeteve të inovacionit si në Evropë ashtu edhe në Azi.” Kina ka demonstruar se, përmes adaptimit, regjimet autoritare mund të inovojnë në mënyrë efektive dhe të konkurrojnë me demokracitë. Aftësia e Shteteve të Bashkuara për të menaxhuar rritjen e autoritarizmit të zgjuar, nga ana tjetër, do të varet nga aftësia e saj për t’u përshtatur.

SI U BË TONY BLAIR MË I FUQISHËM TANI SESA KUR ISHTE KRYEMINISTËR

Nga: Michael WALDMAN, regjisor i dokumentarit të ri *The Tony Blair Story*,^[1] që zbërthen suksesin e jashtëzakonshëm të ish-kryeministrit britanik, Tony Blair / **The Independent**

Në një kohë kur rezonimi politik i Keir Starmerit po vihet në pikëpyetje, dekadën kur Tony Blair ishte në pushtet disa po e shohin si një epokë të artë stabiliteti dhe prosperiteti - si dhe të menaxhimit të zgjuar politik. Ai e emëroi Peter Mandelsonin, por më pas e shkarkoi dy herë.

Tony Blair nuk ishte thjesht udhëheqësi më i suksesshëm elektoral i Partisë Laburiste në historinë e saj - tri fitore të njëpasnjëshme në zgjedhjet e përgjithshme, përfshirë atë që erdhi dy vjet pas asaj që shumë vetë e shohin si gabimin e tij më të rëndë, pushtimin e Irakut - por, gjithashtu, pasi hyri në Kryeministri [Downing Street] në fillim të dyzetave, ai ka ndërtuar një karrierë të dytë të jashtëzakonshme. Instituti “Toni Bler” për Ndryshim Global [Tony Blair Institute for Global Change - TBI] punëson rreth një mijë vetë në afro 50 vende. Pasi e binda të merrte pjesë në serinë tonë me tri pjesë në Channel 4, Historia e Toni Blerit [The Tony Blair Story], e pyeta nëse ka po aq pushtet tani sa kishte në Kryeministri [No 10]. Ai u përgjigj: “Jo aq pushtet sa kisha kur isha kryeministër - por, ndikim - po, deri diku.”

Si e ushtron ai atë ndikim? Ish-ministrat, e po ashtu ish-kryeministrat, variojnë nga figura të dështuara e të konsumuara, të promovuara shumë përtej aftësive të tyre, deri tek udhëheqës të mprehtë me intuitë, përvojë dhe aftësi të qëndrueshme politike që janë të paçmueshme.

Instituti i Blairit publikon sasi të mëdha kërkimesh mbi shumë nga çështjet me të cilat qeveritë aktuale po përballen, dhe vetë Blairi këshillon personalisht udhëheqës në mbarë botën. Gjatë pandemisë, për shembull, TBI-ja e zhvendosi të gjithë fokusin e tij në këshillimin e qeverive për përballimin e kësaj sfide të paprecedentë për shërbimet publike. Siç më ka thënë Tom McTague, redaktor i New Statesman: “Ishte Instituti ‘Toni Bler’ që dukej se ishte përpara qeverisë. Papritur fillove të shihje kryeministra që shkonin të takonin Tony Blairin ose që i kërkonin Tony Blairit të vinte në Kryeministri. Liz Truss e takoi, Boris Johnsoni e takoi, dhe Keir Starmer sigurisht që e takoi para se të bëhej kryeministër. Ky është lloji i ndikimit që ai ka arritur të ndërtojë për veten”.



Çfarëdo që të mendosh për Tony Blairin, ai është pa mëdyshje një figurë kyçe në historinë e Britanisë. Ai është gjithashtu një njeri bota e të cilit, në disa aspekte, është rrënuar - prioritetet e tij në fund të fundit ishin pjesëmarrja në Evropë, inkurajimi i globalizimit të menaxhuar, ndërhyrja dhe një qasje centriste kundër si të majtës ashtu edhe të djathtës. Gati 20 vjet pas largimit nga detyra, ai ende lufton për ato ide - por, siç më tha: “Nëse do të më kishe thënë se Nigel Farage do të bëhej një aktor kyç në politikën britanike dhe Jeremy Corbyn do të drejtonte Partinë Laburiste, do të kisha thënë se kjo nuk do të ndodhte kurrë - por, gabova. Të dyja ndodhën”.

Ai vazhdoi: “Njerëzit në këto vitet e fundit janë zhvendosur ndaj disa prej gjërave për të cilat unë këmbëngulja ... por, unë mbetem i përkushtuar ndaj atyre gjërave ... Historia nuk është statike, ajo ndryshon dhe njerëzit, mendoj unë, me kohë do të kuptojnë se ka merita në pozicionin që unë kisha”. Siç e thotë McTague: “Ekziston një ndjenjë e tij si një lloj personazhi tragjik, por në kuptimin origjinal grek të ballafaqimit me fatin, duke u përpjekur të skalisë botën në një rend botëror liberal, ndërkombëtar, demokratik. Kjo ishte ajo që përfaqësonte Britania bleriste. Britania do të ishte fanari i kësaj bote dhe pastaj ajo shembet në diçka krejtësisht ndryshe nga ajo që ai imagjinonte, por megjithatë ai ende i qëndron besnik idesë se mund ta shohë të ardhmen”. Gjithmonë pragmatist, siç është, ai megjithatë po përshtatet ndaj realiteteve, për

shembull të punës me presidentin aktual të ShBA-së. Bindja e Blairit se ai ende ka diçka për të ofruar nuk është e kujdesshme: është një hap i rrezikshëm për reputacionin e tij në bashkimin me bordin ekzekutiv të “bordit të paqes” të Trumpit.

Ai është një figurë kaq kontroverse - subjekt i një shkalle urrejtjeje të thellë që pak udhëheqës e përjetojnë - sa që isha i intriguar të shihja se si i menaxhon emocionet e veta kur përballet me një përbuzje të tillë. Qëndrueshmëria është qartësisht një cilësi e nevojshme për të gjithë udhëheqësit, por edhe një shkallë mizorie: isha i intriguar të depërtoja në sipërfaqe për të kuptuar çfarë çoi në suksesin e tij të jashtëzakonshëm në të kaluarën - dhe vendosmërinë e tij për të vazhduar që të ushtrojë ndikim në të tashmen.

E përballa me Irakun, me personazhet e dyshimtë me të cilët u mor pasi u largua nga Kryeministria, me dëshirën e tij për të bërë para etj. Nganjëherë u bë i irrituar nga këmbëngulja për këto pyetje, dhe ndonëse nuk e humbi kurrë plotësisht qetësinë, u hap në mënyra të papritura, në aspektin emocional dhe psikologjik. Ai foli me ndjesi të vërtetë për ngjarjet traumatike familjare në fillim të moshës madhore: dukej në prag të lotëve kur fliste për natën e zgjedhjeve të majit 1997, duke përmbushur ëndrrën e të atit për t’u bërë kryeministër, por duke i munguar nëna e ndjerë. Pas muajsh të tërë përpjekjesh, arritëm të intervistonim edhe Cherien [gruan e Blairit], e cila është jashtëzakonisht e hapur,

dhe më pas fëmijët e tij. Është një portret intim, ndonëse prekës.

Natyra e jetës familjare, kur jeton në atë që Cherie e përshkroi si “akuariumin” e Kryeministrit, është patjetër e çuditshme me pasiguritë e saj të veçanta. E pyeta për atmosferën në kohën e votimit në Parlament për pushtimin e Irakut: “Ai ishte shumë i vetëdijshëm se kjo mund të nënkuptonte që ai të mos ishte më kryeministër dhe se do të nënkuptonte ... një tronditje të madhe për familjen tonë. Dhe, kështu ai u ul me tre më të mëdhenjtë [fëmijët e tyre] ... se të gjithëve mund të na duhej të largoheshim deri në fund të javës nëse do ta kishte humbur votimin”.

Tre nga fëmijët e tij që intervistova - Euan, Kathryn dhe Leo - nuk kishin folur kurrë më parë për të atin dhe ishin të relaksuar, gazmorë dhe të hutuar. Lidhur me efektin e peshës së përgjegjësisë të të atit, Euani tha: “Mund të shihje që kishte momente të presionit ekstrem, sidomos kur ai merrte vendime madhore, veçanërisht ato që përfshinin jetë njerëzish. Babai gjithmonë ka pasur këtë zakon ... do të flisje me të ... dhe ai do të shpërbente dhe do të mendonte për diçka krejtësisht tjetër, dhe mund të shihje që momentet e asaj shpërbente shtoheshin ndërsa më shumë gjëra rëndonin mbi supet e tij”. Dhe, për faktin që i ati nuk rri thjesht ulur në një kolltuk me një libër të mirë, Kathryn theksoi: “Ai nuk ndalet. Mendoj se është më i zënë sesa ishte atëherë”. Pse? “Sepse ai thjesht nuk ka mbaruar. Ai dëshiron të bëjë punën që kishte vendosur

të bënte dhe, kështu, nuk do të ndalet”.

Folëm me kritikët dhe me kolegët - disa prej të cilëve ishin vetë çuditërisht të ashpër. Peter Mandelson, të cilin arrita ta intervistoj një ditë para se të fluturonte për në Uashington për të marrë detyrën e tij të atëhershme si ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në ShBA, erdhi i shpërqendruar nga moria e detyrave që ende duhej të përfundonte para se dita të mbaronte, por në 55 minutat që patëm me të, ai e lavdëroi dhe po ashtu e kritikoi ish-shefin e tij. Ajo intervistë u zhvillua një vit më parë, para se të dilte në pah shkalla e marrëdhënies së tij me Jeffrey Epsteinin.

Të jetosh në Planetin Bler për disa muaj ishte një përvojë magjepsëse: edhe disa prej atyre që ishin kundërshtarët e tij më të mëdhenj nuk mund të mos admironin aftësitë e tij të jashtëzakonshme. Duke e intervistuar Blairin gjerë e gjatë, pashë vetë aftësinë e tij fenomenale për të të bindur dhe për të të magjepsur - por, edhe mendjen e tij ende tejet të mprehtë. Ai nuk ka nevojë për ndonjë këshilltar imazhi apo person të marrëdhënieve me publikun për ta këshilluar se si të përballet me pyetje të vështira - dhe duket rehat në lëkurën e vet.

Ish-presidenti Bill Clinton, duke përshkruar një debat që kishin pasur, më tha: “Siç themi ne në shtëpi, ai mund ta bindte një buf të zbriste nga pema”. /Telegrafi/

[1] *The Tony Blair Story* jepet në Channel 4 më 17, 18 dhe 19 shkurt, në orën 21:00.



SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Mirrored
Security
Paving



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

UEFA ME SHKRIM SPECIAL PËR DRITËN: KOSOVARËT NË PRAG TË HISTORISË

Shtëpia e futbollit evropian, UEFA ka publikuar një shkrim për kampionin në fuqi të Kosovës, FC Dritën. Gjilanasit të enjten mbrëma do të përballen me Celjen në Play-Off të Ligës së Konferencës, në një sfidë ku synojnë fitore për të vazhduar të shkruajnë një tjetër histori për ta dhe për futbollin kosovar. Drita dhe Celje takohen të enjten me fillim nga ora 21:00 në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë.

MË POSHTË ËSHTË SHKRIMI I PLOTË I PËRKTHYER NGA UEFA PËR DRITËN:

Kampionët e Kosovës, FC Drita, po përgatiten për përballjen e tyre në fazën eliminatore të Ligën e Konferencës, me mundësinë për ta vazhduar serinë e tyre historike, duke mbajtur mbi supe shpresat jo vetëm të një klubi, por të një vendi të tërë. “Për të qenë plotësisht i sqartë, nuk e menduam kurrë se do të merrnim tetë pikë pas katër ndeshjeve të para – as unë, as lojtarët”, ka thënë trajneri

Zekirja Ramadani. Duke u bërë vetëm klubi i dytë nga Kosova që arrin fazën e ligës, përkatësisht fazën e grupeve, të një gare madhore të UEFA-s, Ramadani ishte i vetëdijshëm për sfidën që e priste skuadrën e tij në këtë edicion. Megjithatë, një seri mbresëlënëse prej dy barazimesh dhe dy fitoresh u siguroi atyre një vend në fazën eliminatore – dhe me të, një kapitull historik si klubi i parë nga Kosova që përparon në fazën nokaut të një kompeticioni për klube të meshkujve të UEFA-s. Pavarësisht pritjeve, te Drita nuk ka pasur shenja mbingarkese nga pesha e historisë.



“Madje mund të flas edhe në emër të pronarëve tanë, as ata nuk e prisnin. Por ne kemi punuar pa u lodhur”, shtoi Ramadani. “Jam i bindur se suksesi nuk vjen thjesht kështu; ai duhet të meritohet dhe jam i bindur se ne e kemi merituar këtë sukses”.

“Është një ëndërr të jem pjesë e një turneu evropian”

Mes Dritës dhe raundit të 16-të qëndron skuadra sllovene NK Celje. Përpara ndeshjes së parë, besimi



në kampin gjilanas është i lartë. “Ne kemi cilësinë dhe vullnetin për ta kaluar fazën eliminatore”, ka thënë kapiteni Rron Broja, i frymëzuar nga mundësia për të garuar në skenën evropiane. “Të jesh pjesë e Ligës së Konferencës do të thotë shumë, për ekipin dhe për tifozët e Dritës. Për një futbollist të lindur dhe të rritur në Kosovë, ka qenë gjithmonë ëndërr të jetë pjesë e një turneu evropian dhe mendoj se kjo është një nga arritjet e mia më të mëdha”, shtoi ai.

Krenari kombëtare

Arritja në raundin e 16-të do të përfaqësonte një moment

historik jo vetëm për klubin, por për gjithë futbollin kosovar. Pavarësisht rezultatit ndaj Celjes, suksesi i Dritës tashmë është arsye krenarie. “E kemi bërë të gjithë Kosovën krenare dhe është përgjegjësi e madhe të veshësh këtë fanellë”, theksoi Broja. Edhe portieri Faton Maloku ndan të njëjtin mendim: “Kualifikimi në Evropë është shumë i rëndësishëm për ne si komb – jo vetëm si klub”. “Ne kemi një histori të thellë, me periudha shumë të vështira. E gjithë kjo është si një shpërblim për sakrificat e njerëzve që kanë kaluar nëpër ato kohë”, tha portieri gjilanas i Dritës. /Telegrafi/

CHAMPIONS LEAGUE: REAL MADRID FITON NË LISBONË NDAJ BENFICA, PARIS SAINT-GERMAIN PËRMBYS AS MONACO, NDËRSA GALATASARAY SHKATËRRON JUVENTUS NË NJË NATË DRAMATIKE TË PLAY-OFF-it

Real Madrid ka shënuar një fitore të rëndësishme 1-0 në transfertë ndaj Benfica, në ndeshjen e parë të fazës play-off, falë një goli vendimtar të Vinícius Júnior. Sfidat e zhvilluar në Lisbonë ishte e luftuar dhe e tensionuar, ndërsa trajneri José Mourinho u ndëshkua me karton të kuq dhe nuk do të jetë në stol në takimin e kthimit. Pjesa e parë ishte e balancuar, me raste nga të dyja skuadrat. Kylian Mbappé dhe Vinícius rrezikuan për madrilenët, por portieri vendas u tregua i vëmendshëm. Në minutën e 50-të erdhi momenti vendimtar, kur Vinícius realizoi një aksion individual të shkëlqyer dhe shënoi me një goditje të saktë brenda zonës për 1-0. Ndeshja u ndërpre përkohësisht pas thirrjeve raciste nga tribuna, ndërsa tensioni u rrit në minutat

e fundit. Mourinho fillimisht u ndëshkua me karton të verdhë për sjellje jospportive dhe në minutën e 85-të mori edhe kartonin e kuq, duke u përjashtuar nga stoli. Benfica provoi të reagojë në fund, por Reali administroi avantazhin dhe mori një fitore të çmuar në transfertë. Ndërkohë, Paris Saint-Germain ka bërë një përmbysje spektakolare ndaj AS Monaco, duke fituar 3-2 dhe duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt kualifikimit. Monaco mori avantazhin e dyfishtë, pasi Folarin Balogun shënoi që në minutën e parë dhe më pas realizoi edhe golin e dytë në minutën e 18-të. PSG humbi një penallti me Vitinha, por reagoi shpejt duke ngushtuar diferencën në 2-1 me Désiré Doué në minutën e 29-të. Në të 41-tën, Achraf Hakimi riktheu

baraspeshën në 2-2. Në pjesën e dytë, kampionët e Evropës përmbysën gjithçka, teksa Doué realizoi golin e tretë, duke plotësuar dygolëshin personal. Një tjetër ndeshje spektakolare u zhvillua në Turqi, ku Galatasaray triumfoi 5-2 ndaj Juventus. Në minutën e 15-të, Gabriel Sara kaloi në avantazh vendasit, ndërsa vetëm një minutë më pas Teun Koopmeiners barazoi rezultatin. Në minutën e 32-të ishte sërish holandezi që kaloi bardhezinjtë në avantazh, rezultat që qëndroi deri në fund të pjesës së parë. Pjesa e dytë ishte një makth për “Zonjën e Vjetër”, e cila u barazua nga Noa Lang në minutën e 49-të. Në të 60-tën, Davinson Sánchez përmbysi rezultatin në favor të ekipit turk. Situata u përkeqësua për miqtë kur Juan Cabal u



ndëshkua me karton të kuq në minutën e 67-të, duke i lënë ata me 10 lojtarë. Vendasit përfituan në mënyrën më të mirë, duke shënuar edhe dy herë të tjera, një herë sërish me Lang dhe në fund

me Sacha Boey. Kështu, Galatasaray hedh një hap të rëndësishëm drejt fazës së 1/16-ave, ndërsa Juventusit do t'i duhet një mrekulli në Torino për të përmbysur këtë disavantazh.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshepte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.
- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.
- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.
- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.
- “FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greçevci”.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjymnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjymnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



TRADITË QË NGA 1992

